



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"PETRA 2021" SHPK

Une, Shtetasi *Nertan Prifti*, atesia Vangjel ,datelindjes 14.09.1982, shtetas Shqiptar,lindur ne Librazhd e me banim ne Tirane,Rruga "Muhamet Gjollesha",njesia Nr 7,me cilesine e "ortakut themelues " mbajtes i leternjoftimit I20914060L kam redaktuar kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklaroj se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise ne Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per shoqerite tregtare ", ne ligjin " Per Qendren Kombetare te Biznesit ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor , kam krijuar shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar "PETRA 2021" SHPK

KREUI

Neni 1

Krijimi

Shoqeria " PETRA 2021" SHPK,_eshte person juridik i te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria, fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne *Gjirokaster,Permet,fshati Petran,zona kadastrale 2946, pasuria 56/48.*

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4

Kohezqatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



Neni 5
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Ne fushen e turizmit:

Investime ne turizem rural, hapje axhensi turistike, bujtine, bar kafe, restaurant, hoteleri.

Ne fushen e tregetise:

Import, eksport, tregetim me shumice e pakice te artikujve qe lejohen me ligj.

KREU II
KAPITALI
Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë dhe eshte i ndare në 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 lekë. Te zoteruara nga: *Neritan Prifti* kuota me vlerë të pergjithshme qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve.

Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nepermjet akteve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga

administratorët, Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokures.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortakut i vetem.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Ortakut i vetem vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo kohe.

Administrator i shoqerise eshte z.Nertan Prifti, per nje periudhe pese vjeçare sipas ligjit.

Neni 11

Kompetencat

Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetëm. Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.


Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu të drejte të nënshkruaje kontrata të ndryshme në emër e për llogari te Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, operacione financiare, të nënshkruaje aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruaje e hartojë çdo dokument e të kryeje në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo te huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse te Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave te ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe te kryeje veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.



Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktonte në çfarëdoq formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për parashikime si dhe të bëhen dorëzues apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jete :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.
 - b) Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji " Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare"
 - c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.
- Në këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër "

Neni 14
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare",

Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 15
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare e nënshkruhet prej tij.

Nr Cel. 069 45 69 896

ORTAKU I VETËM

Nertan Rusthi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER DRITA B. PEPI**

**DATE 14/04/2021
NR REP 860**



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 14.04.2021 , para meje Notere DRITA B. PEPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, GJERGJ FISHTA, KULLAT"GORA", NR. 5/3, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Nertan Prifti, atësia Vangjel, amësia Eliverta, shtetas Shqiptar, lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë, me adresë 'muhamet Gjollësja'; Nd. 67/6; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 14/09/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036535163 dhe nr. personal I20914060L , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Aktin e Themelimit te shoqerise", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
DRITA B. PEPI**